



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

P.SH.Nr.814/22
10/23

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L- 042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Kimete Gashi- Kryetare, Agon Ramadani- Anwtar, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group", me nr: 814/22 ,si dhe ankesës së OE "Vb Tofaj"& PE-VLA-KU sh.p.k, me nr: 10/23, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i pendës në fshatin Vranoc", me nr.të prokurimit: 635-22-6769-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Pejës, me datën 28.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHEN** si të bazuara ankesat e Operatorëve Ekonomik OE "Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group", me nr: 814/22 ,si dhe ankesës së OE "Vb Tofaj"& PE-VLA-KU sh.p.k, me nr: 10/23, për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i pendës në fshatin Vranoc", me nr.të prokurimit: 635-22-6769-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Pejës.
2. **ANULOHET** Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Ri-vlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Me qenë se ankesat e OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group”, si dhe ankesa OE “Vb Tofaj” & PE-VLA-KU sh.p.k aprovohen si të bazuara, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohen Operoret Ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Kuvendi Komunal Pejë, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 12.12.2022, ka publikuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i pendës në fshatin Vranoc”, me nr. të prokurimit: 635-22-6769-5-2-1, ku është rekomanduar për Kontratë grupi i operatorëve ekonomik “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton sh.p.k&Eae-Njaz” sh.p.k.

Kërkesa për ri shqyrtim e OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group”, me datë 19.12.2022, si vendimi për refuzim të kërkesës për ri shqyrtim nga AK: 22.12.2022.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE “Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group” me datën 30.12.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP me numër të protokollit 814/22.

Po ashtu kundër vendimit të AK-së të datës 12.12.2022 për aktivitetin e prokurimit të sipër shënuar me datën 04.01.2023 ankesë në OSHP ka parashtruar edhe Operatori Ekonomik “Vb Tofaj” & PE-VLA-KU sh.p.k, me numër të protokollit 10/23.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur- punë, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimi më të ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 317.964,00 €

Ankesat e OE janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe të njëjtat bien nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 19 janar 2023 me raportin e ekspertizës. AK Komuna e Pejës me datë 20 janar 2023 nuk është deklaruar se a pajtohet a jo me mendimin e ekspertit shqyrtues por vetëm e ka konfirmuar që e ka pranuar dhe lexuar raportin e ekspertit. Me datë 23 janar 2023 OE “Engineering Group sh.p.k. & Çeta - General Invest Group”, ka deklaruar se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE “Vb Tofaj” & PE-VLA-KU sh.p.k me datë 23 janar ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 19.01.2023, eksperti i brendshëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE-ve ankuese , të aprovohen pjesërisht si e bazuara.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 12.12.2022 dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) të grupit të operatorëve ekonomik “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, me nr. ankesë me nr: 814/22 dhe “Vb. Tofaj& PE-VLA-KU sh.p.k me nr. ankesë me nr: 10/23

Pretendim i OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, se AK nuk e ka arsyetuar dhe nuk i ka trajtuar asnjë nga pretendim ankimore kundrejt kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022, ashtu siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues me datë 19.12.2022 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me pretendime ankimore kundrejt ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduara për kontratë dhe shkeljeve të autoritetit kontraktues. AK përmes vendimit të datës 22.12.2022 kundrejt kërkesës për rishqyrtim nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore përkundër faktit që parashtruesi i ankesës ka kërkuar një gjë të tillë përmes kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022. Mos trajtimi i pretendimeve ankimore apo mos dhënia e përgjigjeve në pretendime ankimore nga AK Komuna e Pejës është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, përkatësisht paragrafin 8, 9 dhe 12 të këtij neni. Sipas kësaj dispozite ligjore, përveç tjerash, AK është e obliguar të përgjigjet në pretendime ankimore dhe ti trajtoj kërkesat/prendimet e ankuesit. Andaj pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm.

Pretendim i OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, se të gjitha kontratat e OE të rekomanduara për kontrata “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz” shpk janë të nënshkruara nga Durim Beqiraj person i cili nuk ka dorëzuar autorizim se ka këtë të drejtë për të nënshkruar kontrata dhe i njëjti sipas të dhënave në ARBK nuk

është as drejtor dhe as përfaqësues i autorizuar, në çfarëdo forme për të bërë nënshkrime të tilla. Rrjedhimisht kontratat nuk mund ti merren për bazë përderisa janë nënshkruar nga një person i paautorizuar në bazë të ligjit apo autorizimit noterial.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 2

Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale.

Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt - minimumi 10 punonjës

Dëshmia 2

Lista e punëtorëve me kontrata ose para kontrata ne emër të këtij projekti minimum 10 punëtorë.

Lidhur me këtë kërkesë Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar që “Të paraqitët stafi që do të angazhohet në këtë projekt, të cilët drejtpërdrejtë janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve dhe në përgjithësi të projektit duke përfshirë edhe stafin profesionale. – Stafi teknik (PUNONJËS) që do të kyçet në projekt -minimumi 10 punonjës”



Ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare ka kërkuar:

“Lista e punëtorëve me kontrata ose para kontrata ne emër te këtij projekti minimum 10 punëtorë” askund nuk është kërkuar që kontratat ose para kontrata e lidhura me punëtor duhet ti nënshkruaj ndonjë person përgjegjës i kompanisë. Megjithatë, bazuar në shkresat e lëndës personi i cili i ka nënshkruar këto kontrata me punëtor ne emër të këtij projekti si punëdhënës është në cilësinë e menaxherit në bazë të dokumenteve. Provë:

Punëdhënësi:
NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I)
Përfaqësuar nga :
DURIM BEQIRAJ - Menaxher

Punëtorësi:
EMRI MBIEMRI
I Punësuarit :
Dorë Loshaj

Nënshkrimi



Nënshkrimi



Pretendim i përbashkët OE “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, dhe “VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK”

Lidhur me pretendimin e njejtë të operatorëve ekonomik ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, dhe “VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK” se AK ka rekomanduar për

kontratë operatorin ekonomik, ku lideri i konsorciumit Lulzim Beqiri B.I me emër tregtar N.T.P “FIDANI- L” me numër të biznesit NUI:810215394 ka shuar biznesin në kohën derisa ka qenë në vlerësim, duke kaluar nga biznesi individual në atë shpk. Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve dhe të ATK, rezulton se ka shuar biznesin me datë:24.11.2022. Ndërsa po me të njëjtën datë 24.11.2022 ka hap biznesin e ri me NUI:811990177 me emër “FIDANI L” SHPK. Me tej, operatorët ekonomik ankues shtojnë se një kompani e shuar nuk mund të hyjë në raporte kontraktuale me një autoritet publik apo privat pasi që e njëjta nuk ekziston si subjekt juridik për nevojat e Ligjit për Shoqëri Tregtare dhe rrjedhimisht nuk mund të quhet operator ekonomik sipas kriterëve të përcaktuara me LPP-në. Firma me të cilën kanë aplikuar në këtë procedurë i bie që asnjë lëvizje, asnjë aktivitet nuk mund të ushtroj nga data 24.11.2022. Tutje, OE ankues kërkojnë që i njëjti dhe i gjithë konsorciumi të futet në listën e zezë për shkak të mashtrimit dhe ndryshimit gjatë procesit të vlerësimit.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz” shpk në ofert ka bashkangjitur dokumentin me titull: PENDA NE FSHATIN VRANOC PJ 2.pdf, ku në faqe 14 gjendet Marrëveshje Mirëkuptimi për Themelimin e Partneritetit (Konsorciumit). Kjo marrëveshje për themelimin e partneritetit është lidhur në mes të NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) në cilësi të liderit dhe FIDANI-BETON SHPK dhe EAE-NJAZ SHPK. Pra në këtë marrëveshje ceket se lideri i grupit është NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I).

Po ashtu, grupi i OE të rekomanduar për kontratë “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz” shpk me ofertë kanë bashkangjitur edhe dokumentet si certifikatat e regjistrimit të biznesit nga ARBK.

Sa i përket se pretendimit se sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, lideri i konsorciumit Lulzim Beqiri B.I e ka shuar biznesin me datë 24.11.2022, ekspertja shqyrtuese sqaron se hulumtimin në faqen zyrtare të ARBK-së, rezulton se anëtari i grupit/lideri NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394 është shuar me datë 24.11.2022. Më posht paraqesim pjesën e shkëputur të informatave nga ARBK për biznesin NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394, në të cilën tregohet data e shuarjes së këtij biznesi:

Lulzim Beqiraj B.I.

Emri i biznesit	Lulzim Beqiraj B.I.
Emri tregtar	N.T.P. "Fidani-L"
Lloji i biznesit	Biznes individual
Numri unik identifikues	810215394
Numri i biznesit	80411901
Numri fiskal	603040935
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	64
Data e regjistrimit	14/03/2001
Kontina	Deçan
Adresa	Baballoq, Arben Qerimaj Nr.180
Telefoni	049/457-432
E-mail	///
Kapitali	€
Statusi në ARBK	Shuar
Data e shuarjes	24/11/2022
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Lulzim	Beqiraj	Agj. i Regjistruar	

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Lulzim Beqiraj	€	%

Njësitë

Megjithatë, për të vërtetuar nëse ky biznes është shuar apo i është ndryshuar lloji i “biznes individual” në llojin e biznesit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, ekspertja shqyrtuese me datë 16.01.2023 i është drejtuar ARBK-së me kërkesë për të dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me shuarjen apo ndryshimin e llojit të biznesit. ARBK me datë 18.01.2023 ka kthyer përgjigje, ku sipas kësaj përgjigje rezulton që subjekti apo lideri i grupit NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394 është shuar me datë 24.11.2022. Më poshtë është shkëputur përgjigja e ARBK-së:



Wed 1/11/2023 3:04 PM

Info Arbk

RE: Kërkesë për verifikim të informatës!

To: Majlinda Beqiraj

Cc: Arben Beqiraj; Vjosa Gradinaj; Shqipe Hot

Retention Policy: Default: 5 years

Expires: 1/11/2023

E nderuar,

Numri mëparshëm i biznesit është NRB: 80411901, me zbatimin e ligjit për numrin unik të identifikues të biznesit ka këtë numër NUI: 810215394 Me datën: 24-11-2022 ky biznes shuhet për shkak të ndërrimit të tipit në "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" SH.P.K. dhe merr numër të ri të biznesit 811990177 dhe me këtë numër vazhdon veprimtarinë si biznesi i ri.

Me respekt,

Pra, duke pasur parasysh përgjigjen zyrtare të ARBK-së dhe tenderin e OE të rekomanduar për kontratë, ku si lider i konsorciumit ishte caktuar NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394, ndërsa pas shuarjes së biznesit dhe hapjes së biznesit tjetër “FIDANI-L SH.P.K.” me numër unik identifikues 811990177, rezulton se lideri i grupit (NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj

B.I) me NUI 810215394) ligjërisht është inekzistent. Në këtë kuptim, tani grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kërkesat e nenit 66.1 të LPP-së.

Po ashtu AK në dosjen e tenderit përkatësisht tek pika 7.1 & 7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale” ka kërkuar si në vijim:

	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale:	Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale		Kërkesa 1. Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH –së	Evidenca 1 Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (ARBK) -kopje Evidenca 2 Certifikata e TVSH-së kopje

Siç u dha sqarimi më lartë, shuarja e biznesit me të cilin ishte themeluar grupi i operatorëve ekonomik, tani më nuk i plotëson kërkesat e nenit 66 të LPP-së Përshtatshmëria Profesionale, sepse dorëzimi i deklaratës nën betim, marrëveshja për themelimin e konsorciumit dhe certifikata e ARBK-së, TVSH-së, etj, ishin plotësuar në emër të biznesit individual NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394. Kurse, gjatë kohës së ri vlerësimit të tenderëve, lideri i këtij grupi kishte shuar biznesin dhe kishte hapur biznes të ri të llojit SH.P.K. (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar). Andaj, pretendimi e OE ankues e kualifikojmë si të qëndrueshëm.

1. Pretendim i përbashkët OE “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, dhe “VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK”

Lidhur me pretendimin e njëjtë të operatorëve ekonomik ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, dhe “VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK” se grupi i OE të propozuar për dhënie të kontratës nuk ka prezantuar zgjatjen e validitetit të ofertës dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit si dhe plotësimin e Formularit C ashtu siç kërkohet në shkresën e AK të dërguar me datë: 18 tetor 2022. Me tej OE ankues potencojnë se ky konsorcium mund të mos ketë validitet të ofertës dhe sigurim të ofertës të pashkëputur siç kërkohet me legjislacionin e prokurimit publik. Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues dhe OSHP të verifikoj edhe njëherë këtë çështje dhe të sigurohet se ekziston validitet i pashkëputur i operatorit ekonomik.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës sqaron se OE i rekomanduar kishte dorëzuar zgjatjen e validitetit të ofertës, vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe plotësimin e Formularit C sipas kërkesës së Autoritetit kontraktues të datës 18 tetor 2022. Andaj Pretendimi është i pa qëndrueshëm.

Provë:

1. Pjesa C: Formular për Dorëzimin e Tenderit
 2. Deklaratë Konfirmimi e datës 19.10.2022 (Vazhdimi i validitetit)
- Siguria e Tenderit numri i polices: 060040010086363 (vazhdimi i sigurimit të ofertës)




Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) të grupit të operatorëve ekonomik VB. TOFAJ; PE-VLA-KU sh.p.k me nr. ankesë me nr: 10/23

Lidhur me pretendimin e 2 të OE ankues VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK që ka të bëjë me validitet të "Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimit Mjedisor". Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimin e cekur me lartë Paneli Shqyrtues e ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.381-395-398/2022 të datës 23.11.2022 dhe ky pretendim është "Res Judicata" sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit:

2. Eksperti i njëjtë shqyrtues, teknik ose profesional i prokurimit, nëse konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar më parë nga paneli shqyrtues, e njofton me shkrim panelin shqyrtues dhe palet ne procedure lidhur me këto pretendime ankimore.

Lidhur me pretendimin e 4. të OE ankues VB. TOFAJ; PE-VLA-KU SHPK se kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me numër të regjistrimit 07-514-DI gjatë periudhës së vlerësimit ka skaduar validiteti prandaj nuk është prezantuar regjistrimi i ri. Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e paisjeve teknike, me gjithsej katër (4) kamion. Kamioni me numër rendor 4 me targa të regjistrimit 07-514-DI në rastin e ofertimit kishte validitet për qarkullim rrugor deri me datë 30.08.2022 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 26.07.2022. Pretendimi ankimor është i pa qëndrueshëm.

Provë



MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorëve ekonomik ankues: "Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group" me numër 814/22 dhe "Vb Tofaj" sh.p.k, me numër 10/23, të aprovohen si pjesërisht të bazuara, të anulohet propozimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet ne **Ri vlerësim**.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor, andaj sqaron:

Përgjigjet e Panelit shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”

Sa i për ketë pretendimit të OE ankues i cili pretendon se AK nuk e ka arsyetuar dhe nuk i ka trajtuar asnjë nga pretendimet ankimore kundrejt kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022, ashtu siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se ky pretendim OE ankues është i qëndrueshëm pasi që AK përmes vendimit të datës 22.12.2022 kundrejt kërkesës për rishqyrtim nuk i ka trajtuar pretendimet ankimore përkundër faktit që parashtruesi i ankesës ka kërkuar një gjë të tillë përmes kërkesës për rishqyrtim të datës 19.12.2022. Mos trajtimi i pretendimeve ankimore apo mos dhënia e përgjigjeve në pretendime ankimore nga AK Komuna e Pejës është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së, përkatësisht paragrafin 8, 9 dhe 12 të këtij neni.

Lidhur me pretendimin e OE ankues i cili pretendon se të gjitha kontratat e OE të rekomanduar për kontrata “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz” sh.p.k janë të nënshkruara nga Durim Beqiraj person i cili nuk ka dorëzuar autorizim se ka këtë të drejtë për të nënshkruar kontrata dhe i njëjti sipas të dhënave në ARBK nuk është as drejtor dhe as përfaqësues i autorizuar, në çfarëdo forme për të bërë nënshkrime të tilla duke pretenduar se rrjedhimisht kontratat nuk mund ti merren për bazë përderisa janë nënshkruar nga një person i paautorizuar në bazë të ligjit apo autorizimit noterial, PSH mbështet përgjigjen e dhënë nga eksperti dhe po ashtu sqaron se bazuar në shkresat e lëndës personi i cili i ka nënshkruar këto kontrata me punëtor në emër të këtij projekti si punëdhënës ishte në cilësinë e menaxherit.

Përgjigjet e Panelit shqyrtues lidhur me pretendimin e njëjtë të dy OE ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group” dhe “VB.TOFAJ” Sh.P.K & “PE-VLA-KU” SH.P.K

Lidhur me pretendimin e njëjtë të operatorëve ekonomik ankues “Engineering Group sh.p.k. & Çeta –General Invest Group”, dhe “VB. TOFAJ; PE-VLA-KU sh.p.k” të cilët pretendojnë se AK ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik, ku lideri i konsorciumit Lulzim Beqiri B.I me emër tregtar N.T.P “FIDANI- L” me numër të biznesit NUI:810215394 ka shuar biznesin në kohën derisa ka qenë në vlerësim, duke kaluar nga biznesi individual në atë sh.p.k, PSH bazuar edhe në raportin ekspertësh shqyrtues sqaron se grupi i OE të rekomanduar për kontratë “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-Beton SHPK&Eae-Njaz” sh.p.k në ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: Penda në Fshatin Vranoc PJ 2.pdf, ku në faqe 14 gjendet Marrëveshje Mirëkuptimi për Themelimin e Partneritetit (Konsorciumit). Kjo marrëveshje për themelimin e partneritetit është lidhur në mes të NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) në cilësi të liderit dhe FIDANI-BETON SHPK dhe EAE-NJAZ sh.p.k, pra në këtë marrëveshje ceket se lideri i grupit është NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I). Grupi i OE të rekomanduar për kontratë “Lulzim Beqiraj B.I&Fidani-

Beton SHPK&Eae-Njaz” sh.p.k po ashtu me ofertë kanë bashkangjitur edhe dokumentet si certifikatat e regjistrimit të biznesit nga ARBK

Sa i përket kwtij pretendimi sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, lideri i konsorciumit Lulzim Beqiri B.I e ka shuar biznesin me datë 24.11.2022, PSH bazuar në sqarimin dhe hulumtimin që e ka bërë ekspertja shqyrtuese në faqen zyrtare të ARBK-së, rezulton se anëtar i grupit/lideri NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394 është shuar me datë 24.11.2022. Si dhe për të vërtetuar nëse ky biznes është shuar apo i është ndryshuar lloji i “biznes individual” në llojin e biznesit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, PSH ia falw besimin argumentimit tw dhwnw nga ekspertja shqyrtuese e cila me datë 16.01.2023 i është drejtuar ARBK-së me kërkesë për të dhënë sqarimet e nevojshme në lidhje me shuarjen apo ndryshimin e llojit të biznesit ku kwsaj pyetje ARBK me datë 18.01.2023 i ka kthyer përgjigje, ku sipas kësaj përgjigje rezulton që subjekti apo lideri i grupit NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394 është shuar me datë 24.11.2022.

Pra, duke pasur parasysh përgjigjen zyrtare të ARBK-së dhe tenderin e OE të rekomanduar për kontratë, ku si lider i konsorciumit ishte caktuar NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394, ndërsa pas shuarjes së biznesit dhe hapjes së biznesit tjetër “FIDANI-L SH.P.K.” me numër unik identifikues 811990177, rezulton se lideri i grupit (NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394) ligjërisht është inekzistent. Në këtë kuptim, tani grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotësojnë kërkesat e nenit 66.1 të LPP-së, siç potencohet:

“Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatojë aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend.”

Siç u dha sqarimi më lartë, shuarja e biznesit me të cilin ishte themeluar grupi i operatorëve ekonomik, tani më nuk i plotëson kërkesat e nenit 66 të LPP-së Përshtatshmëria Profesionale, sepse dorëzimi i deklaratës nën betim, marrëveshja për themelimin e konsorciumit dhe certifikata e ARBK-së, TVSH-së, etj, ishin plotësuar në emër të biznesit individual NTP FIDANI-L (Lulzim Beqiraj B.I) me NUI 810215394. Kurse, gjatë kohës së ri vlerësimit të tenderëve, lideri i këtij grupi kishte shuar biznesin dhe kishte hapur biznes të ri të llojit SH.P.K. (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar). Andaj, pretendimi e OE ankues e kualifikojmë si të qëndrueshëm dhe si i tillë OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigjet e Panelit shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues "VB.TOFAJ" Sh.P.K & "PE-VLA-KU" SH.P.K

Lidhur me pretendimin e 2- të të OE ankues që ka të bëjë me validitet të "Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë -ISO 14001 2015- Sistemi i Menaxhimit Mjedisor", PSH sqaron se pretendimin e cekur me lartë Paneli Shqyrtues e ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.381-395-398/2022 të datës 23.11.2022 dhe ky pretendim është "Res Judicata" sipas nenit 16, pika 2 të Rregullores Nr.01/2020, e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

PSH e vlerëson si të është i pa qëndrueshëm pretendimin e OE ankues "VB. Tofaj; PE-VLA-KU" sh.p.k se kamioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me numër të regjistrimit 07-514-DI gjatë periudhës së vlerësimit ka skaduar validiteti, pasi që bazuar në shkresat e lëndës në dosjen e tenderit shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e pajisjeve teknike, me gjithsej katër (4) kamion. Kamioni me numër rendor 4 me targa të regjistrimit 07-514-DI në rastin e ofertimit kishte validitet për qarkullim rrugor deri me datë 30.08.2022 ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 26.07.2022

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konstaton se AK aktivitetin e prokurimit në fjalë duhet ta kthejë në rivlerësim me qëllim që të aplikohen në tërësi dispozitat, dhe parimet e LPP-së në fuqi, konkretisht nenit 59 të LPP-së dhe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave në raport me kërkesat e vendosura nga vet AK-ja.

Andaj PSH obligon AK t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente dhe komform dispozitave të LPP-së.

Andaj, PSH konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP dhe mbi këtë bazë mbetet pranë dispozitivit të këtij aktvendimi duke anuluar vendimin e AK ndërsa aktivitetin e prokurimit duke e kthyer në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

i x 1 AK - Komuna e Pejës;

1x1 OE- "Engineering Group sh.p.k. & Çeta-General Invest Group me seli në Deçan

1x1 EO - "Vb Tofaj"& PE-VLA-KU sh.p.k dega Kosovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;



1 x 1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.